



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me: Prilijeno: 12.08 2024		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
05-453/01-40099		



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Lipjan, 12.08.2024

THIRRJE PUBLIKE PËR OJQ – të

Bazuar në Rregulloren e MF – NR-04 / 2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve :

1. Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të Regjistruara në Republikën e Kosovës, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në *Avancimin e Kulturës në Komunën e Lipjanit*.

Ky institucion ofron mbështetje financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve në organizimin e FESTIVALIT TË FËMIJËVE

2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekte në organizimin e **FESTIVALIT I KËNGËS PËR FËMIJË „LIPJANI KËNDON 2024“**

Objektivat specifike të kësaj Thirrje janë:

- Promovimi i talenteve të rinj në këndim
- Rëndësia e bashkëveprimit me fëmijë
- Socializmi i fëmijëve mes vete
- Realizimi i garave mes fëmijëve
- Nxitja e kreativitetit
- Permiresimi i vetbesimit

OJQ- të mund të aplikojnë vetëm me një Projekt/program që kontribuojnë në Avancimin , afirmimin e kulturës dhe zbulimin e talentëve të rinj në Komunën e Lipjanit

3. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 7.000,00 euro.

Mjetet do të terhiqen nga kodi Subvencione për entitete jo publike

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për këtë projekt është 6,000.00 euro, ndërsa shuma maksimale për këtë projekt është 7.000,00 euro.

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën 30.08.2024

6. OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti një (1) projekt në kuadër të kësaj thirrje dhe vetëm në një (1) nga fushat prioritare sipas thirrjes. Periudha e zbatimit të projektit është 1 muaj (30 ditë)

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e Organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës. para datës së publikimit të thirrjes publike.

OJQ aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e Kulturës duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Drejtoratit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, **OJQ** duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në **OJQ** dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se **OJQ** ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen personalisht, në adresën e mëposhtme:

KOMUNA E LIPJANIT

Rruga „Shqipëria”

Zyra për shërbim të qytetarëve

Procesi i pranimi, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

8. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: mergim.orucii@rks-gov.net

Anila Reçica Llugiqi
Drejtoreshë e DKRS- së

